



BALANCIMI I PUSHTETIT



NË DEMOKRACI

LIRIA E MEDIAS NË DEMOKRACI

GENTIJANA (12), ARGJEND (12), ELIZA (12), SHKËLQIM (12), MERVA (12), SEFER (12), ALMEDINA (12),
ALBIJON (12), FLORIAN (12)



Në një shtet demokratik, ne duhet të jemi mirë të informuar, e këtë na e mundëson media

Për të bërë një fillim për së mbari, së pari do t'iu tregojmë për kuptimin e fjalës demokraci, fjalë e cila vjen nga greqishtja e vjetër. Ajo përbëhet nga bashkimi i fjalës „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë udhëheqje.

Në shekullin në të cilin po jetojmë, është shumë i rëndësishëm funksionimi i një shteti demokratik dhe i një shoqërie që udhëhiqet nga vullneti i lirë i popullit. Kjo mund të ndodh nëse ne kemi respekt për njëritjetrin, nëse ne solidarizohemi me personat të cilët kanë nevojë për ne, nëse ka tolerancë ndër-racore, e kështu me radhë.

Shekuj më parë, atëherë kur edhe ka lindur demokracia, pra në vitin 507 para erës sonë, ka pasur diskriminime të natyrave të ndryshme. Për shembull, e drejta e shprehjes së lirë nuk i ka takuar çdo njërit. Pastaj, të drejtën e shkollimit nuk e kanë pasur gratë, e shumë padrejtësi të tjera.


Në ditët e sotme, media luan një rol shumë vendimtar për sa i përket ndërtimit të një demokracie të mirëfilltë. Ajo gjithashtu konsiderohet si pushteti i katërt pas Pushtetit Legjislativ (Kuvendi), Pushtetit Gjyqësor (Gjykata), si dhe Pushtetit Ekzekutiv (Qeveria). Ne e kemi të drejtën për të qenë të informuar mirë. E kjo ndodh vetëm përkrah mediave të lira.

Në ditën kur është shpallur Kosova shtet demokratik, gjithë ceremoninë e asaj dite, e kemi shikuar përmes televizorit, bashkë me familjarët tanë. Po të mos ekzistonte media, neve do të na pamundësohej transmetimi i drejtpërdrejtë i një dite të paharrueshme si ajo e Ditës së Shpalljes së Pavarësisë.


Meqenëse, ne sot e kemi rolin e gazetarëve, po shpresojmë se do të arrijmë t'iu bindim juve të dashur lexues, për të mirat e demokracisë si dhe rëndësinë e medias në të. Pra, qytetarë të dashur, le t'i shfrytëzojmë të drejtat tona dhe le të bëhemi qytetarë demokratik, ashtu siç edhe e kërkon demokracia.




Ne jemi gazetarë dhe ne i informojmë qytetarët për demokracinë në shtetin tonë



Para ligjit ne të gjithë jemi të barabartë, pa dallim gjinie dhe pa asnjë dallim tjetër




Të drejtë vote në Kosovë ka çdo qytetar i cili ka arritur moshën 18 vjeçare




Media luan rol të rëndësishëm në demokraci, sepse përmes saj ne mund të marrim informata të sakta



Në demokraci, zëri i të gjithë qytetarëve të Kosovës dëgjohehet dhe mendimi i të gjithëve vlerësohet



Edhe pse ne jemi shokë e shoqe, ne jemi persona të ndryshëm me kërkesa dhe interesa të ndryshme




Të gjithë qytetarët duhet t'i zbatojnë me përpikëri rregullat e komunikacionit

SHTËPIA E POPULLIT

DIANA (12), LEARTA (12), GENTIAN (13), ILIRJANA (12), ARBER (12), BENET (14), ERONA (12),

DIANA (12)



Kuvendin e kemi paraqitur në libër, sepse ashtu siç libri e ushqen trurin e njeriut, njëjtë edhe Kuvendi i begaton me të mira qytetarët e vet përmes ligjeve të cilat i miraton

Pa gjëra të vlefshme jeta do të dukej më e zbehtë, e tillë do të ishte jeta jonë pa Kuvendin

Ne jemi ende fëmijë dhe si të tillë që jemi ne gëzojmë shumë të drejta. Të drejtat tona janë të patjetërsueshme dhe çdo fëmijë anë e kënd botës, duhet t'i gëzojë ato, ashtu siç ne i gëzojmë.

Këto të drejta që ne i kemi, i gëzojmë falë punës së palodhshme të Kuvendit të Kosovës. Kuvendi natyrisht që nuk mendon vetëm për të rriturit, por po ashtu edhe për fëmijët. Kur themi për të rriturit, aty përfshihen edhe të moshuarit, ku ne vet jemi dëshmitarë se gjyshërit tanë i marrin pensionet e tyre. Pa dyshim, që ata kanë punuar për këto ditë, mirëpo pa u miratuar ligji për pensione, i gjithë mundi i tyre nuk do të shpërblehej sot.

E njëjta vlen edhe për familjet të cilat nuk i kanë shumë të mira kushtet ekonomike. Këto familje marrin ndihmë sociale apo thënë ndryshe ndihmë me të holla nga buxheti i shtetit. Edhe këtë pa dyshim që e bënë Kuvendi. Për t'i gëzuar të gjitha këto të mira, përkujdesen 120 deputetë, të cilët janë të zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Deputetët përveç këtyre që ne i cekëm, kanë miratuar edhe shumë ligje të tjera që kanë të bëjnë me ambientin, transportin, zhvillimin ekonomik e shumë të tjera. Nuk duhet kaluar këtë artikull pa treguar pak edhe për funksionet e Kuvendit, siç janë: përfaqësimi i popullit,



Këtu kemi paraqitur disa të mira të tjera të Kuvendit

mbikëqyrja e Qeverisë dhe miratimi i ligjeve. Neve si qytetarë, na prekin që të tri funksionet e përmendura, sepse zëri ynë dëgjohej në Kuvend. Duke u miratuar kështu ligje për ne, e që i vë në funksion ose në zbatim pastaj Qeveria, e cila kontrollohet nga Kuvendi, përmirësohet jeta jonë. E gjithë kjo punë realizohet që ne të kemi një jetë të lumtur.



Ne jemi grupi „Toka“

VOTA E DREJTË

ENSAR (12), VERONA (12), ARJANIT (12), DONAT (12), DRIN (12), LEONIT (13), RINOR (12), UVJES (12),

VALMIR (12)



Një artikull i këndshëm që flet për zgjedhjet

Që kur isha e vogël, kisha dëgjuar shumë për zgjedhjet. E dija se ky proces ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për shtetin. Në lajme, në rrugë, kudo flitej shumë kur ishte koha e zgjedhjeve. Koha kalonte dhe erdhi dita ku mund të merrja pjesë edhe unë në këtë proces, sepse kisha mbushur 18 vjet. U zgjova atë mëngjes më datë 22 tetor. Në Kosovë po mbaheshin zgjedhjet komunale. Unë jam pjesë e këtij procesi

pjesë e vendimmarrjes në vendin tim. Isha i lumtur që jetoj në Kosovën demokratike dhe që e gëzoja të drejtën e votimit. Mirëpo, jo vetëm unë. Të gjithë qytetarët e Kosovës e gëzojnë këtë të drejtë, pa asnjë dallim. Procesi zgjedhor i radhës për zgjedhjet komunale është pas 4 vjetësh. Megjithatë, unë kisha njohuri se mund të votoj prapë në zgjedhjet parlamentare, ku populli ka mundësinë të zgjedh deputetët, të cilët na përfaqësojnë në Kuvend. Të dashur lexues, ta dini se vërtet qytetarët e vendeve demokratike gëzojnë shumë të drejta. Por, një ndër të drejtat më të rëndësishme është e drejta e votës. Mos lejo asnjëherë që kjo e drejtë e jotja të mos shfrytëzohet nga ti. Fuqia jote kalon tek përfaqësuesit. Bëhu ti personi i cili vendos se kush do ta ketë këtë fuqi. Bëhu ti ndryshimi. Këtë mund ta bësh përmes procesit zgjedhor, ku ti vendos për vendin tënd, me votën tënde.



si, vazhdoja t'ia përsërisja vetes këtë fakt. Ndihesha shumë i rëndësishëm dhe i lumtur. Gjatë tërë kohës, unë i kisha ndjekur me shumë vëmendje fushatat zgjedhore të kandidatëve për kryetarë të komunës. Isha i vetëdijshëm se kështu veprojnë qytetarët e mirë. Andaj, isha i sigurt se kush e meriton votën time. Kështu shkova dhe votova. Ishte një ndjenjë shumë e veçantë, sepse vota ime do të bënte një ndryshim dhe unë isha



Gazetarët demokratik, të cilët e shkruajtën këtë artikull dhe të cilët treguan për rëndësinë të cilën e ka vota



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Abdullah Shabani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Mitrovicë